

VENDIM
Nr. 509, datë 1.8.2012

**PËR LIRIMIN, MANDATIMIN DHE RIMANDATIMIN E DISA ANËTARËVE TË KËSHILLIT
KOMBËTAR TË KONTABILITETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Selman Lamaj lirohet nga funksioni i anëtarit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit për shkak të përfundimit të mandatit.

2. Z. Limos Malaj mandatohet anëtar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, propozuar nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA).

3. Znj. Flutura Kalemë rimandatohet anëtare e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, propozuar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës.

4. Z. Jorgji Bollano rimandatohet anëtar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, propozuar nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha